DALESE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-785/18 -VI-
Data. Datum. Date. 21.09.2022

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | **Ramiz Lladrovci**, Kryetar i Komunës së Gllogocit<br>**Milaim Hajdari**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gllogocit | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Elbert Krasniqi**, Ministër i MAPL-së<br>**Venera Çerkini**, Zv, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | **Besim Myrtezani**, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 05.09.2022<br>Nr. 020-785 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>Kujtim Aliu, Zyrtar i Lart Ligjor | |
| Lënda: | Shqyrtim i ligjshmërisë e aktit të Kuvendit të Komunës | |
| Lloji i aktit: | Vendim | |

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në mbështetje të nenit 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK)nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MAPL, me datë 01.09.2022 ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë Vendimi Nr. 020/04-046339 për formimin e komisionit vlersues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtëshme te komunes të datës 31.08.2022 të miratuar nga kuvendi i komunës së Gllogocit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe:

**KONFIRMON**

Vendimi Nr. 020/04-046339 për formimin e komisionit vlersues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtëshme te komunes e datës 31.08.2020 të kuvendit të komunës së Gllogocit, në aspektin procedural *është në pajtim* me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

**Arsyetim**

Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.08.2022, ka miratuar VendiminNr. 020/04-046339 për formimin e komisionit vlersues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtëshme te komunes.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Gllogocit është bazuar në nenin 11, 12 dhe neni 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Gllogocit, nenin 17 të Ligjit Nr.03/L-92 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtëshme të komunës, nenin 17 të regullores nr.09/2022 për percaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtëshme të komunës. ***Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Gllogocit me datë 31.08.2022.***

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë lidhur me ketë vlerësim.

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020 - 785/18 -VI-
Data. Datum. Date. 21.09.2022

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za : | **Ramiz Lladrovci**, gradonačelnik opštine Glogovac<br>**Milaim Hajdari**, predsedavajući Skupštine opštine Glogovac | |
| Kopija: | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-a<br>Jedinici za administarciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | **Elbert Krasniqi**, ministar MALS-a<br>**Venera Çerkini**, zamenica generalnog sekretara MALS-a | |
| Od: | **Besim Myrtezani**, zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština / MALS | Datum:<br>05.09.2022<br>br. 020-785 |
| Odgovorni službenici:<br>1. Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:<br>2. Službenik-ca za izradu pravne procene: | **Xhevat Tafa**, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština<br>Kujtim Aliu, službenik za monitorisanje opština | |
| Predmet: | Razmatranje zakonitosti akta Skupštine opštine | |
| Vrsta akta: | Odluka | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavjući,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa članom 81.4 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, Uredbom Vlade br. 02/2021 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni-dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, MALS je dana, 1.9.2022.godine, primilo radi procene zakonitosti Odluku br. 020/04-046339 o formiranju komisije za procenjivanje sprovođenja postupaka davanja na korišćenje opštinske nepokretne imovine, od 31.8.2022. godine, usvojenu od strane Skupštine opštine Glogovac.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS) je razmotrilo zakonitost dotičnog akta, i:

**POTVRĐUJE**

Odluku br. 020/04-046339 o formiranju komisije za procenjivanje sprovođenja postupaka davanja na korišćenje opštinske nepokretne imovine, od 31.8.2022. godine, Skupštine opštine Glogovac, u proceduralnom aspektu ***je u suglasnosti*** sa odredbama zakonodavstva na snazi.

**Obrazloženje**

Skupština opštine Glogovac na sednici održanoj dana, 31.8.2022.godine, usvojila je Odluku 020/04-046339 o formiranju komisije za procenjivanje sprovođenja postupaka davanja na korišćenje opštinske nepokretne imovine.

MALS, konstatuje da je usvojena Odluka od strane Skupštine opštine Glogovac , zasnovana na članu 11, 12 i članu 40 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članu 34 tačka 34.6 Statuta opštine Glogovac, članu 17 Zakona br. 03/L-92 o davanju na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine, članu 17 Uredbe br. 09/2022 o o utvrđivanju postupaka davanja na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine. ***Odluka je usvojena na sednici Skupštine opštine Glogovac dana, 31.8.2022.godine.***

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.

Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës

02 Nr 020/04 - 46339 dt. 31/08 2022

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40,të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 34,pika 34.6, të Statutit te Komunës së Drenasit, bazuar në nenit 17, të Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Vendimit nr.02-463-38614, të datës 27.07.2022 për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të komunës së Gllogocit në shfrytëzim afatgjatë, Konfirmimi i ligjshmërisë Nr.020-654/10 i datës 16.08.2022 i vendimit 02-463-38614, të datës 27.07.2022, Kuvendi i Komunës së Drenasit-Gllogocit në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur më **31.08. 2022 të miratoi këtë:**

# V E N D I M

**Për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

**Neni 1**

Miratohet Vendimi nga Kuvendit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurta në përbërje prej pesë (5) anëtarëve, të cilin Komision e përbejnë dy (2) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës, të cilët i propozon Kryetari i Komunës, dy (2) anëtar nga Kuvendi i Komunës, nga subjektet e ndryshme të përfaqësuar në Kuvend dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar, i cili propozohet nga sektori jo qeveritar lokal, si vijon:

1. Flutra Avdiu anëtar nga ekzekutivi,
2. Enver Hoxha anëtar nga ekzekutivi,
3. Qendrim Mula anëtar nga kuvendi,
4. Salih Dvorani anëtar nga kuvendi dhe
5. Arben Kuliqi anëtar nga sektori jo qeveritar.

**Neni 2**

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit Vlerësues janë zbatimi i procedurave sipas nenit 19, të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 19 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

**Neni 3**

Komisioni vlerësues pas kryerjes së procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të komunës, ofertën e përzgjedhur e procedon ashtu siç parashihen në paragrafin 2 dhe 3 të nenit 19 të ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

**Neni 4**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Mimim Hajdari**

Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatëse;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit;

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
Zyra e Kryetarit

**Nr** 01-020/04-43639 **dt.** 17/08/**2022**

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h)të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit te Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Vendimit nr.02-463-38614, të datës 27.07.2022 për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të komunës së Gllogocit në shfrytëzim afatgjatë, Konfirmimi i ligjshmërisë Nr.020-654/10 i datës 16.08.2022 i vendimit 02-463-38614, të datës 27.07.2022, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur më ______________2022 të aprovoi këtë:

# PROPOZIM VENDIM

Për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

## Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës formimi i komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurta në përbërje prej pesë (5) anëtarëve, të cilin Komision e përbejnë dy (2) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës, të cilët i propozon Kryetari i Komunës, dy (2) anëtar nga Kuvendi i Komunës, nga subjektet e ndryshme të përfaqësuar në Kuvend dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar, i cili propozohet nga sektori jo qeveritar lokal, si vijon:

1. ________________________ anëtar nga ekzekutivi,
2. ________________________ anëtar nga ekzekutivi,
3. ________________________ anëtar nga kuvendi,
4. ________________________ anëtar nga kuvendi dhe
5. ________________________ anëtar nga sektori jo qeveritar.

## Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit Vlerësues janë zbatimi i procedurave sipas nenit 19 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 19 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të

Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

**Neni 3**

Komisioni vlerësues pas kryerjes së procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të komunës, ofertën e përzgjedhur e procedon ashtu siç parashihen në paragrafin 2 dhe 3 të nenit 19 të ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

**A R S Y E T I M**

Komuna e Drenasit pas pranimit të konfirmimit Nr.020-654/10 të datës 16.08.2022 të ligjshmërisë se vendimit Nr.02-463-38614, të datës 27.07.2022 për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të komunës së Gllogocit në shfrytëzim afatgjatë, si dhe në përputhje me obligimet ligjore, ashtu siç parashihet në nenin 13 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe me qellim të vazhdimit të procedurave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim, formon komisionin vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në përbërje ashtu siç parashihet sipas legjislacionit në fuqi.